

JORGO BULO

25 VJET STUDIME SHQIPTARE NË LËMIN E HISTORISË SË LETËRSISË

Pas çlirimit të vendit nga zgjedha nazi-fashiste më 29 nëntor 1944 dhe me fitoren e revolucionit popullor, i cili hapi faqen më të ndritur të historisë së popullit tonë, në Shqipëri u krijuan mundësi të pakufizuara për zhvillimin e përgjithshëm të shkencave. Gjatë këtij një çerek shekulli, si në çdo sektor të jetës, u arritën rezultate të rëndësishme edhe në fushën e studimeve letrare, të cilat vetëm pas vendosjes së pushtetit popullor u zhvilluan në mënyrë të organizuar dhe sistematike.

Rezultatet me të cilat vijmë në këtë jubile studjuesit tanë të letërsisë bëhen edhe më të dukshme po të kemi parasysh që në këtë sferë puna nisi thuajse nga fillimi. Ndryshe nga disa degë të tjera të shkencave albanologjike, si historia apo gjuhësia, trashëgimi shkencor i së kaluarës në fushën e studimeve letrare ishte tepër i varfër. Përpjekjet e studjuesve të veçantë para çlirimit kishin karakter sporadik dhe të kufizuar, prandaj as që u arrit dot të krijohesh një shkencë shqiptare për letërsinë. Veprat e pakta që u botuan atëhere ishin kryesisht tekste shkollore e krestomaci; ato, në rastin më të mirë, kishin karakterin e sprovave historiografike të pjesshme ose të përgjithshme dhe qenë ndërtuar mbi bazën e koncepteve idealiste.

Shkenca e re shqiptare për letërsinë, sikurse edhe shkencat e tjera shoqërore, që në fillim u mbështet në botëkuptimin marksist-leninist, i cili i dha asaj bazën e nevojshme filozofike-metodologjike. Tezat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, metoda dialektike e analizës, i ndihmuan studjuesit tanë për interpretimin shkencor të fakteve dhe fenomeneve letrare, për shpjegimin e tyre nga pikëpamja historiko-shoqërore.

Formimi i shkencës sonë për letërsinë u bë në luftë me mbeturinat e metodologjisë idealiste dhe me ndikimet e shkencës letrare borgjeze e klerikale. Studjuesit i kapërcyen vështirësitë që u delnin në këtë drejtim duke përvetësuar hap pas hapi parimet e metodologjisë shkencore më të përparuar, të metodologjisë marksiste-leniniste.

Një rol të rëndësishëm për zhvillimin e shkencës shqiptare për letërsinë kanë lojtur vendimet dhe dokumentat e KQ të PPSH si dhe fjalimet e shokut Enver Hoxha mbi probleme të ndryshme ideologjike, mbi probleme të historisë dhe të letërsisë shqiptare, mbi epokën e Rilindjes sonë kombëtare, mbi problemin e raportit midis traditës dhe novatorizmit në ndërtimin e kulturës së re etj.

Këta dokumenta kanë përcaktuar detyrat e shkencave albanologjike në tërësi dhe të shkencës për letërsinë në veçanti, i kanë çelur asaj shtigje të reja, e kanë orientuar drejt për ta trajtuar në mënyrë të re historinë e letërsisë shqiptare të epokave të ndryshme.

Në luftën për ngritjen e kulturës së re socialiste, një rëndësi të madhe kishte përcaktimi i qëndrimit që duhej mbajtur ndaj trashëgimit kulturor të së kaluarës e në mënyrë të veçantë ndaj traditave në fushën e letërsisë. Në vitet e para pas çlirimit krahas mbeturinave të koncepteve

nacionaliste borgjeze, që u shprehën në tendencën për të zbukuruar të gjitha vlerat kulturore dhe letrare të mëparshme, pati edhe raste të nënvleftësimit dhe madje të qëndrimit mohues ndaj tyre. Këto shfaqje pengonin njohjen dhe përvetësimin krijues të elementëve demokratikë dhe patriotikë të kulturës kombëtare si dhe shfrytëzimin e tyre për krijimin e kulturës së re, socialiste nga brendia e kombëtare nga forma. Në këto rrethana patën rëndësi të veçantë një sërë dokumentash të partisë, si vendimi i KQ të PPSH të vitit 1950 mbi kremtimin e jubileut të katër përfaqësuesve të shquar të Rilindjes sonë kombëtare, të N. Frashërit, S. Frashërit, A.Z. Çajupit e K. Kristoforidhit, dhe më vonë fjalimet e shokut Enver mbajtur në mbledhjen e gjërë me shkrimtarët dhe artistët në korrik të vitit 1961 e në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit në nëntor të vitit 1962.

Këta dokumenta i bëjnë një vlerësim të drejtë kritik marksist-leninist trashëgimit tonë kulturor dhe përcaktojnë nevojën e studimit të këtij trashëgimi, jo vetëm për të njohur të kaluarën e vendit dhe të popullit tonë por edhe «për të mësuar nga eksperiencia e të parëve tanë, për të pasuruar e zhvilluar vlerat kulturalë që na kanë lënë trashëgim, sipas kushteve e kërkesave të reja të shoqërisë sonë socialiste»¹. Duke u nisur nga një kuptim i tillë, studimi i traditave përparimtare në letërsinë shqiptare të së kaluarës u vu mbi një bazë të shëndoshë dhe i shërbeu zhvillimit të revolucionit kultural e formimit të kulturës sonë të re.

Zhvillimin e studimeve historiko-letrare e ndihmuajn kërkesat dhe nevojat e kulturës dhe të arësimit popullor. Zbatimi në vitin 1946 i reformës arësimore, e cila e vuri shkollën në një bazë shkencore dhe demokratike, sidomos ngritja e institucioneve të larta arësimore si e Institutit Pedagogjik dyvjeçar (1946) dhe më vonë katërvjeçar, (1951) nxorën nevojën e hartimit të teksteve ku të ndriçohej në mënyrë të plotë, mbi bazën e metodologjisë marksiste-leniniste, procesi i zhvillimit historik të letërsisë, të nxirreshin në pah rrymat përparimtare në historinë e letërsisë shqiptare dhe të përcaktohej roli dhe vendi i tyre në kulturën tonë kombëtare. Kërkesa për tekstin e historisë së letërsisë sonë ngrihej jo vetëm nga nevojat që kishte shkolla², por edhe për të mbushur një zbrazëti të madhe që ndjenin masat dhe njerëzit e frontit të kulturës për një vepër të tillë.

Baza për studimin shkencor dhe të organizuar të historisë së letërsisë shqiptare u hodh me krijimin e seksionit të gjuhës, letërsisë dhe folklorit pranë Institutit të Shkencave që u ngrit qysh në vitin 1947. Në bashkëpunim të ngushtë edhe me forcat shkencore nga institucionet e tjera, seksioni ndërmori një varg punimesh mbi autorë dhe probleme të veçanta të historisë së letërsisë sonë, të cilat do të shërbenin si bazë

1) Nga fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e gjerë me shkrimtarët dhe artistët (mbajtur më 11 korrik 1961) «Drita», 1961, 6 gusht.

2) Nevojat e ngutshme të shkollës u plotësuan në fillim me botimin e disa dispensave e teksteve hartuar nga studjues të ndryshëm, si: Kodra Z., *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe* (botim i Ministrisë së Arësimit) T., 1952; Kodra Z., *Letërsia e vjetër shqipe* (Dispensë e shaptilografuar e Institutit Pedagogjik) T., 1956; Kodra Z., *Letërsia arbëreshe* (Dispensë e shaptilografuar e Institutit Pedagogjik), T., 1956; Shuteriqi Dh. S., *Historia e letërsisë shqipe të Rilindjes* (Dispensë e Institutit Pedagogjik) 1948; Shuteriqi Dh. S., *Historia e letërsisë shqipe* (për shkollat e mesme) T., 1955 dhe Xhuvani A., *Letërsia e vjetër dhe letërsia arbëreshe* (Tekst i shaptilografuar për Institutin Pedagogjik Dyvjeçar), Botim i dytë i rishikuar e i plotësuar, T., 1949. Me këto vepra shkenca jonë e re letrare bënte hapat e para. Ato shërbyen si një bazë e mirë për punën e ardhme.

për hartimin e tekstit të ardhshëm. Kjo punë u vazhdua mbi një bazë më të gjerë nga sektori i historisë së letërsisë pranë Institutit të historisë dhe të gjuhësisë i cili u organizua në vitin 1955. Një zhvillim të mirë studimet në fushën e letërsisë morën sidomos pas krijimit më 1957 të Universitetit Shtetëror të Tiranës, që është qendra më e madhe dhe më e rëndësishme arësimore dhe shkencore e vendit.

* * *

Midis problemeve të karakterit të përgjithshëm që ju desh studjuesve tanë të zgjidhnin që në krye, ishte së pari ai i periodizimit të letërsisë shqiptare. Duke i dhënë një përgjigje të re këtij problemi, shkencën jonë letrare sheshti etapat themelore të zhvillimit të letërsisë shqiptare në përputhje me konceptin marksist për studimin e procesit historiko-letrar lidhur ngushtë si me zhvillimin historiko-shoqëror e kulturor të popullit ashtu edhe me ndryshimet e brendshme në vetë gjirin e letërsisë.

Si rezultat i një kuptimi të tillë e në pasojë të vlerësimit të traditave patriotike e demokratike të së kaluarës nga një kënd i ri vështrimi, pamja e zhvillimit historik të letërsisë shqiptare doli më e plotë e më e pasur. Kështu, u zgjerua kuadri i etapës së parë të letërsisë sonë (shek. XVI-XVIII)³ ku u përfshi dhe vepra e historiografëve humanistë shqiptarë të shek. XVI, Barletit e Beçikemit. Duke ju shmangur një kundrimi të ngushtë gjuhësor të letërsisë si lloj i artit, vepra e këtyre humanistëve edhe pse e shkruar në gjuhën latine, u trajtua si pjesë e kulturës sonë, sepse ishte pjellë e jetës shqiptare të kohës dhe pasqyroi problemet e ngjarjet historike të asaj periudhe nga pozitat e luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesit të huaj.

Në fushën e studimit të letërsisë së vjetër shqiptare një punë e mirë u bë me zbulimin e një sërë veprash poetike të panjohura ose të njohura në mënyrë të pjesshme. Si rezultat i një pune kërkimore sistematike të kryer nga punonjësit shkencorë të Institutit të historisë e të gjuhësisë, u hetuan dhe dollën në dritë shumë dorëshkrime të panjohura të përfaqësuesve të rrymës letrare të bejtexhijve që mori jetë në shek. XVIII e nisi të shterrojë që në gjysmën e parë të shekullit XIX, por që njëhej fare pak nga studimet e së kaluarës.⁴ Në këtë mënyrë ndryshoi dhe përfytyrimi për zhvillimin letrar e kulturor në këta shekuj⁵.

3) Çështje të ndryshme të letërsisë së vjetër të shekujve XVI-XVIII u trajtuan në një varg monografish e artikujsh, shumica e të cilëve u botuan, siç janë: Demiraj Sh., *Jul Variboba (1762)*, «Buletin USHT, Ser. shk. shoq.», 1958, 1, 125-144; Domi M., *Libri i parë shqip dhe fillimet e letërsisë shqipe*, «Bul. shk. shoq.», 1955, 1, 3-8; Lacaç H., *Pjetër Budi vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, «Studime filologjike», 1966, 4, 151-158.

4) Kontribut në zbulimin dhe studimin e prodhimit letrar të bejtexhijve solli edhe O. Myderrizi. Shih për këtë: Myderrizi O., *Erveheja dhe Muhamet Çami*, «Bul. Inst. Shk.», 1951, 1, 72-81; *Nezim Frakulla (1690 (?) -1759)*, «Bul. shk. shoq.», 1954, 4, 56-76; *Hasan Zyko Kamberi*, «Bul. shk. shoq.», 1955, 1, 93-109 etj. Shih edhe: Gjyli A., *Zenel Bastari — vjershëtar i gjysmës së parë shek. XIX*, «Buletin i USHT, Ser. shk. shoq.», 1961, 1, 148-180.

5) Kësaj i shërbyen edhe studimet që u ndërmorën për disa figura të lëvizjes kulturore të Voskopojës në shek. XVII-XVIII, si edhe për shqipëruetit elbasanas të ungjillit (shek. XVIII). Shih: Qafëzezi I. M., *Kostë Haxhi Jorgji Çekani nga Voskopoja*, «Bul. shk. shoq.», 1954, 3, 117-119; Po ai, *Theodor Kavaljoti (Monografi në dorëshkrim, ruhet në Arkivin e Institutit të historisë e të gjuhësisë)*; Po ai, *Dhaniel Haxhi Voskopojari (Monografi në dorëshkrim, po aty)*; Shuteriqi Dh. S., *Anonimi i Elbasanit, shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri*, «Bul. Inst. Shk.», 1949, 3, 34-54; Shuteriqi Dh. S., *Dhaskal Todhri* «Bul. shk. shoq.», 1954, 4, 35-53.

Por rezultati më i rëndësishëm që arriti shkenca letrare shqiptare në studimin e periudhës së parë të zhvillimit të letërsisë sonë, nuk ka të bëjë aq me faktin që u zgjerua kuadri i prodhimit letrar të kësaj faze, se sa me interpretimin e ri ideologjik dhe me aspektin e ri në të cilin u studjua ky prodhim. Ndryshe nga ç'ndodhte në shkencën e paraqirimit, prodhimi letrar i më të hershmes fazë të historisë së letërsisë shqiptare nuk u pa ngushtë nga pikëpamja linguistike, as si fakt kulture më vete, por u bënë përpjekje për ta studjuar letërsinë e vjetër nga një kriter më i gjerë shkencor, për ta parë atë si element të kulturës e si një fenomen të rendit ideologjik, duke vënë në qendër të vëmendjes problemin e lidhjes së saj me historinë e popullit e të rolit të saj sado të kufizuar për zhvillimin e kulturës kombëtare. Duke e drejtuar vëmendjen në çështjet e gjinisë e të stilit, studjuesit u përpoqën të hetojnë në këtë prodhim letrar elementet artistike që ndihmuuan për formimin e letërsisë së Rilindjes kombëtare shqiptare, si një letërsi e re, me përmbajtje të thellë kombëtare e me vlera të larta artistike.

Fusha që tërhoqi vëmendjen e pjesës më të madhe të studjuesve gjatë këtij një çerek shekulli ishte letërsia e Rilindjes kombëtare. Kjo ndodhi jo sepse në këtë lëmë ekzistonte që përpara një farë tradite, por për shkak të vendit të veçantë që zë në trashëgimin përparimtar të kulturës kombëtare krijimtaria e shkrimtarëve të shquar patriotë të Rilindjes. Prodhimi letrar përparimtar i kësaj periudhe, në të cilin gjetën shprehje aspiratat e masave të gjera të popullit për liri, përbën një etapë të re më të lartë të zhvillimit ideor dhe artistik të letërsisë sonë, shënon një hap cilësor në rrugën e zhvillimit të saj historik.

Këto rrethana si dhe synimi për t'iu përgjigjur kërkesës së shkollës së re për sqarimin e traditave përparimtare në letërsinë e së kaluarës bënë që trashëgimi letrar i kësaj periudhe t'i nënshtrohej studimit të shtuar dhe plot rezultate nga ana e shkencës së re shqiptare për letërsinë.

Faza e parë e studimeve në këtë fushë u kurorëzua me aktivitetet shkencore që u organizuan në kuadrin e jubileut të rilindësve të shquar në vitin 1950 dhe me botimin e një sërë artikujve e studimeve të cilët sollën materiale të reja për jetën dhe veprimtarinë letrare të N. Frashërit, S. Frashërit, A.Z. Çajupit e K. Kristoforidhit dhe hodhën dritë mbi disa anë të historisë së letërsisë sonë. Më vonë kjo punë vijoi me hartimin e studimeve me karakter monografik për jetën dhe veprën e N. Frashërit, A.Z. Çajupit, N. Mjedës, N. Veqilharxhit, Th. Mitkos, Asdrenit, R. Siliqit, L. Gurakuqit etj.⁶

6) Shih: Fullani Dh., *Risto Siliqi (1882-1936)*, «Bul. shk. shoq.», 1956, 2, 58-100; Po ai, *Asdreni* (monografi e pabotuar, 1957, ruhet në arkivin e Institutit të historisë dhe gjuhësisë); Po ai, *Papa Kristo Negovani*, «Bul. USHT, Ser. shk. shoq.», 1960, 2, 183-221; Po ai, *Patrioti poet Loni Logori (1871-1929)*, «Bul. USHT, Ser. shk. shoq.», 1961, 3, 100-116, etj.; Gurakuqi M., *Poeti e patrioti Ndre Mjeda*, «Bul. shk. shoq.», 1956, 3, 81-135; Islami M., *Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi, T.*, 1967, 132 f.; Kasratrati J., *Zef Jubani (Ndokilia)*, «Bul. shk. shoq.», 1955, 1, 75-92; Lacaq H., *Luigj Gurakuqi 1879-1925. Shënime mbi jetën dhe veprën e tij letrare*, «Bul. USHT, Ser. shk. shoq.», 1959, 4, 162-176; Po ai, *Hilë Mosi (1885-1933). Shënime mbi jetën dhe veprën e tij letrare*, «Bul. USHT, Ser. shk. shoq.», 1961, 3, 88-99; Po ai, *Dom Ndoc Nikaj (1864-1951). Shënime mbi jetën dhe veprat*, «Bul. USHT, Ser. shk. shoq.», 1963, 1, 184-197; Musaraj Sh., *Naim Frashëri* (Konferencë me rastin e 50-vjetorit të vdekjes), «Letërsia jonë», 1950, 10, 33-65; Sako Z., *Sami Frashëri shkrimtar dhe patriot i shquar i Rilindjes* (Konferencë akademike me rastin e 100-vjetorit të lindjes), «Letërsia jonë», 1950, 6, 45-62, Spasse S., *Mihal Grameno (1872-1931)*, «Bul.

Gjithashtu në artikujt e studime të tjera u prekën probleme të ndryshme të krijimtarisë letrare të rilindësve, si problemi i lidhjeve të letërsisë së Rilindjes me folklorin, problemi i karakterit, rrymave ideologjike dhe gjinive që lëroi kjo letërsi, si dhe çështje të tjera më të veçanta⁷.

Punimet monografike dhe artikujt shkencorë të botuara pas çlirimit ndihmuan të rishikohej përfytyrimi i vjetër i njëanshëm mbi letërsinë e Rilindjes kombëtare. Shkenca jonë letrare përpunoi një koncept më të drejtë e më të saktë shkencor për karakterin, brendinë dhe rolin e shquar që lojti letërsia e Rilindjes në zhvillimin e lëvizjes sonë për çlirim kombëtar. Mbi bazën e këtij koncepti kjo letërsi u studjua në lidhje të ngushtë me jetën e popullit, me luftën e tij për të flakur tej zgjedhën e huaj qindravjeçare dhe për të hyrë në rrugën e zhvillimit demokratik. Në lidhje me përpjekjet e tij për liri, tokë, dritë dhe përparim shoqëror. Nga ana tjetër, duke zbatuar tezën leniniste të dy kulturave brenda kulturës kombëtare, studjuesit e historisë së letërsisë kanë meritën se ndriçuan aspekte të lëna në hije nga shkenca e paraçlirimit dhe krahas karakterit patriotik vunë në pah frymën e theksuar demokratike që shquan veprën e një radhe shkrimtarësh përparimtarë të Rilindjes kombëtare. Kështu u vunë në dukje motivet demokratike dhe antif feudale që përshkojnë veprën e A. Z. Çajupit, Asdrenit, R. Siliqit, motive që hasen gjithashtu në shtypin e fillimit të këtij shekulli (në shkrimet e Gramenos, S. Nivicës etj.) për të cilat heshte në tekstet e paraçlirimit. Edhe karakteri patriotik i veprave letrare të periudhës së Rilindjes u ndriçua në një dritë të re, në kuadrin e luftës shoqërore — politike të kohës.

Rezultate të shënuara gjatë këtij një çerek shekulli u arritën edhe në studimin e letërsisë së arbëreshëve të Italisë. Kjo letërsi, ndonse lindi në truall të huaj, u përftua nga lëvizja shqiptare për çlirim kombëtar, shprehu idealet e kësaj lëvizjeje dhe ruajti marrëdhënje të vijueshme e të ngushta me të. Duke u parë si pjesë integrale e letërsisë së Rilindjes kombëtare dhe, duke u vendosur në kontekstin e luftës për çlirim kombëtar, u shpjegua nga një bazë e shëndoshë brendia patriotike e letërsisë arbëreshe dhe u riveluan vlerat e saj të veçanta artistike. Veprat e au-

shk. shoq.», 1956, 1, 40-75; Shuteriqi Dh. S., *Çajupi (Jeta dhe vepra e tij)*, «Literatura jonë», 1947, 5, 1-22; Po ai, *Naim Frashëri* (me rastin e 48-vjetorit të vdekjes së tij), «Literatura jonë», 1948, 6-7, 18-63; Po ai, *Andon Zako Çajupi (11 korrik 1930-1950)*, (Konferencë akademike me rastin e 20-vjetorit të vdekjes), «Letërsia jonë», 1950, 7, 45-71; Po ai, *Kostandin Nelko Kristoforidhi (1830-1895)*, *Monografia mbi jetën dhe botimet e tij* «Bul. i Inst. Shk.», 1950, Nr. 1-2, 3-37 dhe Nr. 3, 3-22; Treska M., *Kostandin Kristoforidhi*, «Letërsia jonë», 1950, 1, 55-83; Xhuvani A., *Naimi si poet e si prozator*, «Literatura jonë», 1947, 3-4, 9-30; Zheji Gj., *Andon Zako Çajupi — Jeta dhe vepra*, T., 1966, 95 f.

7) Shih: Bihiku K., *Rrymat ideore e artistike dhe gjinitë e letërsisë shqipe që nga fundi i shek. XVIII e gjer në ditët tona*, «Studime filologjike», 1967, 1, 3-11; Brahimi R., *Skënderbeu në letërsinë e Rilindjes kombëtare*, «Studime filologjike», 1967, 4, 59-70; Bulo J., *Rreth ndikimit të folklorit në veprën e Çajupit*, «Studime filologjike», 1966, 2, 107-117; Fullani Dh., *Poezia e Asdrenit militante për liri e demokraci*, «Bul. UShT. Ser. shk. shoq.», 1962, 2, 169-193; Gurakuqi M., *Çajupi si komediograf*, «Nëndori», 1966, 3, 113-123; Po ai, *Çështje të krijimit letrar të Ndre Mjedës*, «Studime filologjike», 1966, 4, 21-51; Spasse S., *Idetë demokratike dhe revolucionare të M. Gramenos*, «Nëndori», 1961, 2, 172-179; Shuteriqi Dh. S., *Mbi disa çështje të letërsisë shqipe të Rilindjes Kombëtare* (Në librin: «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë 15-21 nëndor 1962. T., 1965, f. 292-299); Varfi A., *Disa tipare karakteristike të poezisë së Ndre Mjedës*, «Nëndori», 1966, 12, 159-165; Zheji Gj., *Çajupi dhe folklori*, «Nëndori», 1966, 3, 97-112 etj.

torëve të saj të shquar si Jeronim De Radës, Gavril Darës, Zef Serembes etj., që më parë thuajse nuk njiheshin fare nga masat, u studjuan dhe u popullarizuan në shkallë të gjerë⁸.

Të gjitha rezultatet që u arritën në studimin e letërsisë së vjetër shqiptare dhe të letërsisë së Rilindjes sonë kombëtare u përgjithësuan në tekstin e historisë së letërsisë shqipe⁹. Kjo vepër është një sukses i rëndësishëm i shkencës shqiptare për letërsinë; në të janë sintetizuar rezultatet e deritanishme në studimin e letërsisë shqiptare mbi bazën e një metodologjie të re me të vërtetë shkencore. Historia e letërsisë shqipe është vepra më e rëndësishme me karakter përgjithësues historiko-letrar, që u krye nga shkenca e re shqiptare për letërsinë.

Rezultate të rëndësishme janë arritur edhe në studimin e letërsisë shqiptare të viteve 1912-1939. Së pari duhet thënë se vetëm pas çlirimit letërsia përparimtare e kësaj periudhe u bë objekt studimi shkencor. Studjuesit dhe kritikët letrarë të paraçlirimit, duke ngritur ato figura që shprehën në veprat e tyre tendencat më reaksionare të epokës, shtrembëruan ose lanë qëllimisht në harresë prodhimin letrar demokratik dhe përparimtar të viteve 1912-1939, sepse në të ishin pasqyruar synimet dhe aspiratat e shtresave të gjera të popullit për shndërrime me karakter demokratik.

Shkenca jonë e re ka meritën jo vetëm se bëri të njihen vlerat ideore dhe artistike të letërsisë përparimtare të viteve 1912-1939, por edhe se shpjegoi karakterin e saj duke u nisur nga një kuptim i drejtë shkencor i përmbajtjes së etapës në të cilën ajo lindi, i drejtimit të luftës shoqërore e ideologjike që u zhvillua në vitet '20-'30 në vendin tonë. Për pasojë shkenca jonë letrare zbuloi rrënjët shoqërore të letërsisë përparimtare të viteve '20--'30 si letërsi e përfutur nga lëvizja e shtresave demokratike kundër rendit çifligaro-borgjez. Gjithashu duhet thënë se shkenca jonë e re tregoi se si kundërpeshë e letërsisë së lëvizjes demokratike, dhe në luftë me të u zhvillua letërsia borgjeze dhe klerikale katolike. Në radhë të parë studjuesit u përqëndruan në krijimtarinë e shkrimtarëve përparimtarë. Me

8) Për letërsinë arbëreshe u ndërmorën studime të veçanta dhe u botuan një radhë artikujsh e monografish, si: Kastrati J., *Jeronim De Rada (Jeta dhe veprat)* T., 1962, 71 f.; Kodra K., *Figura e Skënderbeut në krijimtarinë e De Radës*, «Studime filologjike», 1967, 4, 59-70; Kodra Z., *Lëvizja letraro-kulturale e arbëreshëve të Italisë, si kontribut në çështjen kombëtare shqiptare (shek. XIX-XX)*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 15-21 nëndor 1962», T., 1965, 300-307; Po ai, *Jeronim De Rada si folklorist e poet dhe ndikimi i tij tek shkrimtarët arbëreshë të shek. XIX-XX*, «Studime filologjike», 1964, 4, 51-64; Po ai, *Vinçenc Stratigo (1822-1885)*, «Studime filologjike», 1965, 4, 71-89; Po ai, *Poema «Kënkat e Krujës» e Kozmo Serembes*, «Studime filologjike», 1967, 2, 95-112; Spasse S., *Zef Serembe 1843-1891*, «Bul. shk. shoq.», 1954, 2, 52-69; Shuteriqi Dh. S., *Mbi jetën e krijimtarinë e Zef Serembes*, «Bul. USHT, ser. shk. shoq.», 1961, 4, 69-105; Xhaxhiu M., *Epoka dhe figura e Skënderbeut në disa nga poetët arbëreshë*, «Studime filologjike», 1967, 4, 73-83, etj.

9) Shf: *Historia e letërsisë shqipe*, Vëllimi I, (Folklori e Letërsia e vjetër shqipe), Vëllimi II (Letërsia shqipe e Rilindjes kombëtare), Tekst hartuar nga Dh. S. Shuteriqi, K. Bihiku, M. Domi, V. Bala, Z. Kodra dhe Z. Sako, nën redaktimin e Dh. S. Shuteriqit, K. Bihikut e M. Domit (Botim i USHT — Instituti i historisë dhe i gjuhësisë) T., 1959.

këtë prizëm u studjua vepra e Fan Nolit¹⁰ dhe e Migjenit¹¹, të cilët ishin përfaqësuesit më të shquar të rrymës demokratike përparimtare të letërsisë shqiptare të viteve '20-'30, si dhe krijimtaria e një sërë shkrimtarëve të tjerë shumica e të cilëve është bërë zakon të thirret «brezi i viteve '30»¹²; u bënë gjithashtu përpjekje për të hetuar e për të shpjeguar edhe disa procese të zhvillimit të brendshëm të letërsisë së kësaj periudhe, siç është shfaqja e realizmit, si parim i pasqyrit të jetës¹³. Si rezultat i një pune të gjerë dhe të organizuar u arrit të hartohej në formë dispense për diskutim teksti i letërsisë shqipe të viteve 1912-1939¹⁴, në të cilin jepet në mënyrë pak a shumë të plotë historia e zhvillimit të letërsisë së kësaj periudhe.

Në fushën e studimit të letërsisë shqiptare të së kaluarës u bë një punë e madhe edhe për pasurimin e të dhënave arkivale mbi jetën dhe veprën e shkrimtarëve patriotë të fazës së hershme (shek. XV-XVIII), të epokës së Rilindjes dhe të periudhës 1912-1939 si dhe për botimin e veprave të zgjedhura të tyre. Në sajë të gjurmimit dhe studimit të monumenteve të para të shqipes së shkruar, të cilat u zhdukën nëpër rrebeshet e shekujve, me përkthimin, botimin dhe ribotimin e «Historisë së Skënderbeut» të M. Barletit, të «Skënderbeut» (Apologji) të F. Bardhit si dhe me botimin shkencor të «Mesharit» të Gj. Buzukut (përgatitur prej prof. E. Çabejt) u bënë të njohura traditat e hershme historike e kulturore të popullit tonë, i cili edhe në thellësi të kohës, me gjithë shtypjen e egër dhe pushtimin e huaj, arriti të ruajë vlerat e tij shpirtërore.

Një punë me rëndësi të madhe kulturore dhe filologjike ishte popullarizimi i veprave më të mira të shkrimtarëve të Rilindjes, të cilat iu vunë në dorë masave të gjera të lexuesve. Kjo punë, që nisi në stil të gjërë që me botimin kritik të «Historisë së Skënderbeut» të N. Frashërit (përgatitur dhe komentuar nga prof. K. Cipo), vijoi me veprat e tjera të

10) Shih: Bala V., *Fan S. Noli dhe poezia e tij* (Parathënie e librit: F. S. Noli, «Album», T., 1968); Gjergji A., *Fan S. Noli* (monografi e pabotuar, ruhet në arkivin e Institutit të historisë e të gjuhësisë).

11) Shih: Bala V., *Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni) (1911-1938)*, «Bul. shk. shoq.», 1954, 1, 55-78; Brahimi R., *Migjeni flamurtar i letërsisë sonë luftarake*, «Nëndori», 1958, 8, 137-160; Shuteriqi Dh. S., *Migjeni* (me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së tij), «Literatura jonë», 1948, 8, 1-14.

12) Brahimi R., *Fillimet letrare të Andrea Varfit*, në përmbledhjen «Shënime letrare», T., 1965, f. 336-344; Gurakuqi M., «Hyjt mbi greminë» të Gaspër K. Palit, «Nëndori», 1960, 6, 201-220; Po ai, «Horizonti» i Petro Markos dhe poezia jonë përparimtare e viteve '30, «Nëndori» 1960, 12, 159-194; Po ai, *Disa mendime lidhë me krijimtarinë letrare të Nonda Bulkës*, «Nëndori», 1961, 4, 188-214; Po ai, *Krijimtaria poetike e Kapës në vitet '30*, «Nëndori», 1962, 10, 108-131; Po ai, *Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe të viteve '30*, T., 1966, 280 f.; Po ai, *Krijimtaria letrare e Nonda Bulkës në vitet '30*, (Parathënie e librit: Nonda Bulka «Kur qante e qeshte bilbili», T. 1967); Jorgaqi N., *Romani «Pse?» dhe fillimet letrare të Sterjo Spasses*, «Bul. UShT, Ser. shk. shoq.», 1958, 4, 138-170; Po ai, *Krijimtaria letrare e Sterjo Spasses para çlirimit*, (Parathënie e përmbledhjes: «Kurora e Rinisë» e S. Spasses. T., 1963, f. 3-24); Po ai, *Rruga e një shkrimtari patriot (Haki Stërmilli)*, «Nëndori», 1966, 4, 90-107; Po ai, *Romani «Kalorësi i Skënderbeut»*, i H. Stërmillit, «Studime filologjike», 1967, 2, 81-84.

13) Shih: Bala V., *Çështje të historisë së letërsisë shqipe. Rreth realizmit tonë kritik në «Bota e re» të Korçës*, «Bul. shk. shoq.», 1956, 3, 136-172; Bihiku K., *Problema naroda v peredovoj albanskoj literature (1920-1944)*, «Studia albantica», 1966, 2, 175-183; Gurakuqi M., *Çështje të tematikës dhe të zhvillimit të realizmit në vitet '30*, «Nëndori», 1965, 2, 105-138; Kokona L., *Mendime rreth metodës artistike të Migjenit*, «Studime filologjike», 1965, 3, 131-138.

14) Shih: *Historia e letërsisë shqipe e periudhës 1912-1939* (Dispensë), Botim i UShT (Institutit i historisë dhe i gjuhësisë dhe Fakulteti histori-filologji), T., 1968.

poetit të madh të Rilindjes, «Lulet e verës», «Bagëti e Bujqësi» e gjer tek seria «Vepra të zgjedhura» prej të cilave ka dalë gjer më sot një vëllim, me veprën e A. Z. Çajupit, Asdrenit, N. Mjedës, P.N. Luarasit, F. Shirokës, H. Mosit, R. Siliqit, M. Gramenos, L. Gurakuqit etj., si dhe me vënjen në gjuhën e sotme e me botimin e «Milosaos» së J. De Radës, «Kenkës së sprasme të Balës» të G. Darës (të riut), «Emirës» së A. Santorit, «Vjershave» të Z. Serembes, poemës «Shpata Skanderbekut ndë Dibret poshtë» të B. Bilotës¹⁵, etj.

Për botimin e veprave të shkrimtarëve të Rilindjes u bë një punë e kujdesshme për zgjedhjen e lëndës letrare, për pajisjen e vëllimeve me hyrje, ku analizohet krijimtaria e autorit dhe me shënime përkatëse tekstologjike e shpjeguese. Në këtë mënyrë trashëgimi letrar përparimtar i rilindësve është bërë sot pronë e masave punonjëse, siç është bërë edhe vepra e një radhe prej shkrimtarëve më të shquar demokratë të periudhës 1912-1939, përmes dy botimeve të veprës së plotë të Migjenit, dy botimeve të poezive të F.S. Nolit. Botimit të disa prej veprave të H. Stermillit si dhe të një sërë veprash të autorëve të tjerë të kësaj periudhe.

Studjuesit dhe historianët e letërsisë sonë i kanë kushtuar kujdes gjithashtu gjurmimit dhe zbulimit të veprave të panjohura të autorëve të së kaluarës, të mbetura dorëshkrim, duke nxjerrë në dritë shumë syresh. Kështu u botuan fragmente nga poema e gjatë e A.Z. Çajupit «Baba Musa lakuriq», vjersha të Mjedës, Asdrenit e R. Siliqit, novela e skica të Migjenit dhe të Q. Stafës, vepra të H. Stermillit etj.

* * *

Shkenca për letërsinë i është përveshur edhe studimit shkencor të letërsisë shqiptare të realizmit socialist e cila është në zhvillim e lulëzim të pandërprerë. Duke nisur me pak shkrimtarë dhe me një prodhim të vogël, ajo është kthyer sot në një letërsi artistike të gjerë, të arritur artistikisht dhe me një larmi të paparë individualitetesh krijuese.

Gjinitë kryesore të studimeve mbi letërsinë kanë qenë artikujt kritikë për vepra të veçanta të shkrimtarëve ose probleme aktuale të zhvillimit letrar. Vitet e fundit janë botuar edhe studime shkencore mbi çështje historiko-letrare dhe teorike.

Një nga problemet e para që u kap dhe u rrah nga studjuesit dhe kritikët letrarë ishte problemi i burimeve të realizmit socialist dhe i kohës së formimit të tij në letërsinë shqiptare. Në disa artikuj që u botuan në shtyp nga fundi i viteve 50¹⁶ si kohë e shfaqjes së realizmit socialist u caktuan vitet '20-'30. Sipas autorëve të tyre metoda e re artistike nxori kryet dhe u formua në krijimtarinë e shkrimtarëve demokratë, si Noli, Migjeni dhe të letrarëve të rinj, që ishin të lidhur me lëvizjen e përgjithshme demokratike (P. Marko, Dh.S. Shuteriqi, Q. Stafa etj.). Këto teza

15) Vepra në fjalë u përgatit për shtyp, u pajis me parathënje e shënime nga P. Emanuil Jordani dhe u botua në Tiranë, në kuadrin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, nën kujdesin e Institutit të historisë e gjuhësisë.

16) Shih: Brahimi R., *Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist* (Në përmbledhjen: R. Brahimi «Shënime letrare», T., 1965, f. 5-27), si dhe Brahimi R., *Diskutim rreth kumtesës së K. Bihikut Rreth problemit të lindjes së realizmit socialist në letërsinë shqipe* (Në librin: «Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë, 15-21 nëndor 1962», T., 1965, f. 429-432); Gjyli A., *Migjeni poet i realizmit socialist*, «Bul. shk. shoq.», 1957, 2, 135-203.

ngjallën diskutime të zjarrita. Në seksionin gjuhë-letërsi të Konferencës së parë albanologjike, që u mbajt në vitin 1962, problemi i gjenezës së realizmit socialist zuri një vend të rëndësishëm. Në diskutimin që u ndez, pikëpamjes së mësipërme iu kundërvu mendimi sipas të cilit realizmi socialist u formua në letërsinë shqiptare pas çlirimit, kur parimet e reja të njohjes e të pasqyrimit artistik të jetës u manifestuan në krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të sotëm në tërësinë dhe unitetin e tyre¹⁷. Me sa duket lidhur me problemin e formimit të realizmit socialist në letërsinë shqiptare ka nisur të pranohet pikëpamja e dytë.

Krahas këtij problemi vëmendjen e studjuesve e ka tërhequr edhe problemi i letërsisë së lëvizjes nacionalçlirimtare (1941-1944). Para së gjithash u synua të njihjei prodhimi letrar i këtyre viteve, temat dhe brendia e saj ideore, autorët e saj kryesorë. Fill pas çlirimit u botuan veprat më të njohura që u shkruan në periudhën e luftës kundër pushtuesve fashistë. Janë bërë gjithashtu përpjekje për të hetuar rëndësinë e letërsisë së luftës në zhvillimin e letërsisë shqiptare dhe sidomos për formimin e realizmit socialist¹⁸.

Vjetët e fundit u botuan disa artikuj në të cilët shtrohet problemi i periodizimit më të drejtë të rrugës historike të përshkuar nga letërsia e sotme, i përcaktimit të etapave të cilat formojnë një ndarje tërësore nga pikëpamja e ligjëshmërive të brendshme të procesit historiko-letrar, e pasurimit të letërsisë nga ana tematike-ideore dhe e formave të shprehjes artistike. Duke u nisur nga kjo, studjuesit kanë vënë në dukje se në zhvillimin historik të letërsisë së sotme shqiptare dallohen dy etapa. Përmbajtjen e etapës së parë, që nis me çlirimin e vendit dhe arrin gjer në fund të viteve '50, e formojnë përpjekjet për afirmimin e realizmit socialist si drejtimi kryesor i letërsisë së sotme në Shqipëri. Kurse etapa e dytë, që nis afërsisht nga viti 1960 e vjen gjer në ditët tona, është etapa e konsolidimit të mëtejshëm të realizmit socialist. Në këtë periudhë realizmi socialist zhvillohet në luftë kundër degjenerimit revizionist e borgjez që karakterizon letërsinë e vendeve ku sundojnë klikat revizioniste. Në të njëjtën kohë kjo fazë shquhet nga rritja e mëtejshme artistike e letërsisë shqiptare¹⁹.

Sukseset që arriti letërsia shqiptare në fillim të viteve '60, hyrja në jetën letrare e shumë pendave të reja, me individualitet të qartë krijues, pasurimi i krijimtarisë letrare me forma dhe mjete të reja artistike, nxitën diskutimin mbi traditën dhe novatorizmin. Për herë të parë problemi doli lidhur me zhvillimin e poezisë. Në këtë diskutim, në të cilin morën pjesë kritikë dhe shkrimtarë, u rrah çështja e mjeteve të reja

17) Bihiku K., *Rreth problemit të lindjes së realizmit socialist në letërsinë shqipe* (në librin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 15-21 nëndor 1962»), T. 1965, f. 305-314. Shih për këtë edhe Sliqi D., *Diskutim rreth kumesës së K. Bihikut Rreth problemit të lindjes së realizmit socialist në letërsinë shqipe* (Në librin: «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë 15-21 nëndor 1962») T. 1965, f. 424-428).

18) Midis studimeve që iu kushtuan letërsisë së Luftës nacionalçlirimtare mund të përmendim: Bihiku K., *Rreth zhvillimit të letërsisë shqipe të Luftës Nac. Çl.* «Studime filologjike», 1964, 4, 7-38; Po ai, «*Epopeja e Ballit Kombëtar*» e Sh. Musarajt (në përmbledhjen: «Artikuj kritikë», T. 1968, f. 3-10; Alibali J., *Gjikë Kuqali (1921-1944)*, (Në librin: Gj. Kuqali «Qiriu» — shkrime letrare, T. 1955, f. 5-14; Po ai, *Duke përkujuar Kristaq Tutulanin*, «Nëndori», 1966, 7, 31-35 etj.

19) Shih: Bihiku K., *Si ta ndërtojë kursin e historisë së letërsisë së sotme shqipe*, «Mësuesi», 1968, 6 shtator.

poetike, e vargut të lirë etj.²⁰ Që nga ajo kohë çështja e novatorizmit dhe e traditës ka pluskuar në jetën letrare herë në mënyrë të tërthortë dhe herë hapur. Një rëndësi të veçantë teorike për studimin shkencor të këtij problemi kanë tezat që parashtroi kohët e fundit shoku Enver lidhur me nevojën e kuptimit dialektit të raportit midis traditës dhe novatorizmit²¹. Studjuesit tanë, duke u nisur nga këto tema, do të përpunojnë paskëtaj aspekte të pastudjuara të këtij problemi aktual për zhvillimin e letërsisë sonë.

Në rrethin e gjërë të çështjeve që paraqet letërsia e sotme e që janë bërë objekt shqyrtimi prej mendimit shkencor e kritik, një vend të madh kanë zënë problemet e zhvillimit të gjinive të ndryshme. Kështu nga fusha e prozës janë bërë përpjekje për të studjuar gjendjen e zhvillimit të saj, për të zbuluar karakteristikat e këtij zhvillimi si për gjininë e romanit ashtu dhe për llojet më të shkurtëra; janë trajtuar gjithashtu problemet e raportit të prozës me aktualitetin, janë prekur çështjet që lidhen me tipizimin dhe me heroin në prozën dhe letërsinë tonë në përgjithësi²².

Probleme të kësaj natyre janë studjuar edhe nga fusha e zhvillimit të poezisë²³ dhe dramaturgjisë²⁴ sonë të re. Një vend të veçantë në stu-

20) Shih: Siliqi Ll., *Mbi problemin e traditave dhe mbi novatorizmin* «Nëndori», 1960, 7, 174-184; Siliqi D., *Në kërkimin e së resë* «Drita», 1961, 8, 25, qershor, 2 korrik; Gurakuqi M., *Traditë dhe novatorizëm*, «Drita», 1961, 30 korrik, 13, 20 gusht; Agolli D., *Traditë, natyrisht, por jo shtampë*, «Drita», 1961, 27 gusht, 3 shtator.

21) Hoxha E., *Raporte e fjalime (1967-1968)*, T., 1969, f. 478-490.

22) Shih: Abdihoqha A., *Disa shënime mbi aktualitetin në prozën tonë* «Nëndori», 1962, 8, 111-146; Bihiku K., *Pas leximit të një romani* [«Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë], «Nëndori», 1965, 6, 119-145; Po ai, *Mendime mbi detyrat e ngutshme të romanit tonë të sotëm*, «Nëndori», 1967, 4, 151-170; Brahimi R., *Figura e komunistit në letërsinë tonë*, «Nëndori», 1956, 11, 107-126; Po ai, *Shënime mbi romanin tonë* (Në përmbledhjen: R. Brahimi, «Fjalë për letërsinë», T., 1960, f. 74-117); Po ai, *Bukuri e ashpër e jetës shqiptare*. [Rreth vëllimit me tregime «Kënga dhe pushka» të Dh. S. Shuteriqit], (Në përmbledhjen: R. Brahimi «Shënime letrare», T., 1965, f. 272-287); Siliqi D., *Mbi romanin «Kënetë» të Fatmir Gjatës*, «Nëndori», 1958, 7, 118-128; Shaplo D., *Disa probleme mbi heroin pozitiv*, «Nëndori», 1960, 5, 147-156; Po ai, *Të forcojmë qëndrimin ideologjik në tregimet tona, të pasurojmë brendinë e tyre* (Në përmbledhjen: D. Shaplo, «Letërsia dhe realiteti ynë», T., 1968, f. 91-102 etj.); V. Velça, *Drama e fshatarësisë shqiptare në prakun e çlirimit të saj të plotë* [Rreth romanit «Lumi i vdekur» i J. Xoxes]. Në përmbledhjen: K. Velça, «Vëzhgime letrare», T., 1968, f. 62-90, etj.

23) Shih: Bala V., *Një shprehje e re në poezinë tonë të sotme* [Mbi «Herojtë e Vigut» dhe vjersha të tjera të K. Jakovës], «Nëndori», 1954, 1, 94-100; Brahimi R., *Një vepër poetike me rëndësi* (Shënim kritik për vëllimin «Shekulli im» të I. Kadaresë) (Në përmbledhjen: R. Brahimi, «Shënime letrare», T., 1964, f. 143-153); Kallulli A., *Shënime kritike mbi poemën «Përse mendohen këto male» të I. Kadaresë*, «Nëndori», 1966, 10, 116-133; Po ai, *Mbi poemën «Devoll, Devoll» të D. Agollit*, (Në përmbledhjen: «Artikuj kritikë» T., 1968, f. 37-52); Shaplo D., *Poema në krijimtari të Ll. Siliqit* (Në përmbledhjen «Artikuj kritikë», T., 1968, f. 53-67; Po ai, *Probleme ideore dhe artistike të poezisë sonë* (Në përmbledhjen: D. Shaplo «Letërsia dhe realiteti ynë», T., 1968, f. 5-40); Varfi A., *Për një zhvillim të mëtejshëm të poezisë ndër ne*, «Nëndori», 1959, 5, 210-224 etj.

24) Shih: Çomorua S., *Udha e dramaturgjisë së re shqiptare*, «Nëndori», 1960, 4, 129-145; Hoxha I., *Mbi disa probleme të dramaturgjisë sonë* «Nëndori», 1963, 11, 95-126; Jakova K., *Disa mendime mbi komeditë e kohës së fundit*, «Nëndori», 1958, 12, 115-121; Jakova K., *Vrejtje kritike rreth dy dramave historike* [«Shtatë shaljanët» të Ndrekë Lucës dhe «Trimi i mirë me shokë shumë» të S. Pitarkës], «Nëndori», 1959, 1, 133-145; Mitrojorgji P., *Lart frymën revolucionare të klasës punëtore. Shënime rreth dramës së F. Paçramit*, «Ngjarje në fabrikë», «Nëndori», 1968, 10, 159-171; Shuteriqi Dh. S., *Drama «Halili dhe Hajrija» dhe trajtimi i temave historike në letërsi*, «Letërsia jonë», 1951, 3, 49-62; Velça K., *Rreth disa problemeve të dramës sonë historike* (Në përmbledhjen: K. Velça, «Vëzhgime letrare», T. 1968, f. 151-161); Po ai, *Rreth disa problemeve të dramës sonë* (Po aty, f. 162-184) etj.

dimet tona kanë zënë problemet e zhvillimit të letërsisë për fëmijë²⁵ e cila në këto dekada ka arritur suksese të mëdha dhe është pasuruar me vepra të reja që lozin një rol të rëndësishëm në edukimin e brezit të ri.

Si rezultat i një pune të vazhdueshme kërkimore në lëmin e studimit të letërsisë së sotme u bë e mundur që, duke filluar qysh nga viti 1958, në Fakultetin histori-filogji të jepet një kurs i plotë sistematik mbi historinë e zhvillimit të kësaj letërsie dhe të botohet teksti që analizon prodhimin letrar të periudhës 1944-1964²⁶.

Sukseset që po arrin letërsia jonë në fazën aktuale i kanë vënë studjuesit përpara detyrës së hetimit dhe zbulimit të proceseve dhe tendencave që shtjellohen në gjirin e saj, për të dhënë përgjithësimin shkencor të rrugës së rritjes dhe zhvillimit historik të letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Duke ndjekur këtë proces, studjuesit dhe kritikët letrarë bëjnë përpjekje jo vetëm të përcaktojnë vijat e zhvillimit të letërsisë së sotme shqiptare por edhe të ndihmojnë aktivisht jetën letrare.

Puna e gjerë dhe e vazhdueshme që kryhet në këtë lëmë përmes botimit të studimeve, shënimeve e artikujve kritikë nëpër faqet e shtypit shkencor e letrar prej një radhe studjuesish dhe kritikësh është kontribut me vlerë për studimin e historisë së zhvillimit të letërsisë së sotme dhe një bazë e shëndoshë për ta ngritur nivelin e këtyre studimeve në lartësinë e kërkesave që shtrou zhvillimi i sotëm shkencor dhe thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kultural në vendin tonë.

Dokumentat e fundit të partisë, vendimet e plenumit të VIII të KQ të PPSH për problemet e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës dhe fjalimet programatike të shokut Enver, që kanë pasuruar mendimin shoqëror-shkencor të kohës sonë, i hapin shkencës letrare shqiptare në tërësi perspektiva të reja dhe e vënë përpara detyrash të rëndësishme. Plotësimi i këtyre detyrave lidhet me përpjekjet për forcimin e parimeve të metodologjisë marksiste në studimet historiko-letrare, për ngritjen e mëtejshme të nivelit të tyre shkencor.

Duke qenë e pajisur me një vështrim të ri më të mprehtë klasor e duke zbatuar një analizë më të thellë shkencore të fenomeneve letrare, shkenca jonë për letërsinë ka bërë qysh sot objekt të kritikës së vet disa nga të metat në vlerësimin e trashëgimit letrar të së kaluarës dhe ka riformuluar pikëpamje të reja për probleme të ndryshme të historisë së letërsisë sonë. Kështu janë bërë përpjekje për të përcaktuar më drejt caqet e botëkuptimit të disa shkrimtarëve, për ta shpjeguar procesin letrar dhe veprën e shkrimtarëve në lidhje më të ngushtë me jetën dhe rrymat ideore të kohës, për të koregjuar vlerësimet e njëanshme që ishin shprehur sidomos në idealizimin e shkrimtarëve të veçantë etj.

S'ka dyshim se në rrugën e rritjes dhe të forcimit të saj të mëtejshëm, duke u udhëhequr si gjithmonë nga filozofia marksiste-leniniste, me përkrahjen dhe kujdesin e partisë, shkenca jonë për letërsinë, si një sektor i rëndësishëm i revolucionit ideologjik e kultural, do t'u përgjigjet detyrave që shtrou thellimi i mëtejshëm i këtij revolucionit në vendin tonë.

25) Shih: Dedja B., *Shënime mbi historinë e letërsisë shqipe për fëmijë* «Nëndori», 1957, 3, 174-179; 4, 188-198; 5, 160-169; Po ai, *Për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë sonë për fëmijë e të rinj*, «Nëndori», 1960, 12, 101-121; Po ai, *Disa probleme të letërsisë për fëmijë të këtyre tre vjetëve të fundit*, «Nëndori», 1964, 6, 68-86; Sako Z., *Letërsia jonë për të vegjëlit*, «Nëndori», 1960, 4, 145-154 etj.

26) Shih: Bihiku K., *Letërsia shqipe e realizmit socialist* (Dispensë, ribotim) T., 1968.

R é s u m é

25 ANNEES D'ETUDES ALBANAISES

DANS LE DOMAINE DE L'HISTOIRE DE LA LITTERATURE

Après avoir mi en vue, au préalable, le fait que dans le domaine des études littéraires, le patrimoine scientifique du passé est pauvre, et que le petit nombre de productions faites paraître avant la libération du pays avaient à leur fondement des conceptions idéalistes, l'auteur s'arrête sur les conséquences qu'ont eues la victoire de la révolution populaire et les transformations révolutionnaires en Albanie pour le développement de la science albanaise sur la littérature. Celle-ci commence d'ailleurs sa vie après le triomphe de cette révolution.

S'assimilant constamment les principes de la méthodologie marxiste-léniniste, la science albanaise sur la littérature, a obtenu, durant un quart de siècle de son existence, une suite de résultats remarquables.

Elle a donné une nouvelle interprétation scientifique du chemin qu'ont parcouru les lettres albanaises depuis leurs débuts à nos jours et a résolu plusieurs questions de caractère historico-littéraire. En concordance avec le concept marxiste d'étude du processus historico-littéraire en rapport étroit avec le développement historico-social et culturel du peuple et avec les modifications au sein même de la littérature, notre jeune science des lettres a brossé les étapes fondamentales du développement de la littérature albanaise et a découvert le contenu et les traits propres à toute étape.

Le résultat le plus important acquis dans l'étude de la production littéraire de la première phase de la littérature albanaise (siècles XVI-XVIII), conjointement à l'élargissement de son cadre et de l'enrichissement de sa représentation, était l'interprétation de cette production comme un phénomène de l'ordre idéologique, son examen à partir d'un critérium scientifique plus ample et la découverte des éléments artistiques.

La littérature de notre Renaissance nationale, comme une étape plus élevée du développement idéologique et artistique de la littérature albanaise, s'est soumise, durant ces 25 années, à une étude plus détaillée et plus ample. Notre science littéraire a élaboré, désormais, dans ses lignes fondamentales, une conception scientifique juste et exacte du caractère, du contenu et du rôle éminent qu'a joué la littérature de la Renaissance nationale albanaise dans le développement du mouvement albanais de libération nationale. Etudiée en rapport étroit avec la vie du peuple et avec ses efforts à rejeter le joug étranger centenaire et s'acheminer sur la voie du développement démocratique, se fit jour l'essence patriotique et démocratique de la production littéraire de la Renaissance nationale albanaise et furent élucidés des aspects estompés par les spécialistes d'avant la libération. Ont été faits également des efforts à tracer les régularités du développement intérieur de la littérature dans l'étape donnée et à faire de la lumière sur le fait que ce développement a eu lieu à travers la lutte de l'aile progressiste contre celle réactionnaire, comme expression de la lutte de classes au sein de la littérature.

Les résultats obtenus dans l'étude de l'histoire albanaise ancienne et de l'histoire de la période de la Renaissance nationale ont été synthétisés dans le texte de l'Histoire de la littérature albanaise, qui représente la plus

importante oeuvre historico-littéraire de caractère généralisant, réalisée par la jeune science albanaise sur la littérature.

Un mérite particulier de la jeune science albanaise sur la littérature est l'étude de la littérature progressiste de la période 1912-1939. Partant d'une juste conception scientifique du contenu de l'étape dans laquelle elle prit naissance et de la pointe de la lutte sociale et idéologique qui eut lieu dans les années 20-30 en Albanie, notre science a mis en évidence les couches sociales et les sources idéologiques de la littérature démocratique de ces années, comme une littérature du mouvement des couches démocratiques, qui portait sa pointe contre le régime grand-terrien-bourgeois.

La dernière partie de l'exposé va aux résultats obtenus dans le domaine de l'étude de la littérature contemporaine albanaise. L'auteur fait ressortir que les problèmes qui ont attiré l'attention dans ce domaine ont été celui de la genèse du réalisme socialiste dans la nouvelle littérature albanaise, celui de ses étapes de développement, celui de la mise en évidence du caractère de la littérature du mouvement de libération nationale, celui de la tradition et du novatorisme ainsi que les problèmes du développement et de l'enrichissement des genres et des variétés particulières que cultive, à l'heure que l'on est, la littérature albanaise.

